



Audit Pack for Small- and Medium-Sized Entities

# Paketa e auditimit për Entitetet e Vogla dhe të Mesme

## Udhëzimet e përdorimit

Mars 2014

## Përmbajtje

Përmbajtje.....	2
Hyrja në Pack SMEs .....	2
Faza 1 – Pranimi i angazhimit.....	4
Faza 2 – Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalisë materiale & Planifikimi i auditimit .....	5
Faza 2 – Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalisë materiale & Planifikimi i auditimit .....	6
Faza 3 – Reagimi ndaj rrezikut auditimit .....	7
<b>&amp; Sigurimi i evidencës së</b>	
Faza 4 – Përmbledhje e angazhimit dhe raportimi i opinionit .....	8
Konsideratat praktike.....	9
Si të përdorni toolsat?.....	9
Procedurat për aktivizimet makro.....	9
Pack SMEs marrëveshja e përdorimit.....	10

## Hyrja në Pack SMEs

« Paketa e auditimit për Entitet e Vogla dhe të Mesme », ose « Pack SMEs », e përgatitur nga CNCC në bashkëpunim me IRE - IBR, është një paketë me toolsa e dizajnuar për t'i mundësuar audituesit të planifikojë dhe kryejë procedura auditimi dhe të strukturojë mënyrën e auditimit për SME-të, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Grafiku i kësaj qasjeje jepet në faqen 10.

Këto toolsa janë përgatitur për t'iu kursyer juve kohë. Në dizajnimin e tyre, janë marrë në konsideratë karakteristikat e SME-ve dhe nuk duhet të përdoren në situata të tjera pa modifikime paraprake. Në këtë kontekst , ato mund të grupohen në dy kategori:

- « **Mjetet (toolsat) e strukturimit** »: konsiderohen si esenciale për mënyrën e auditimit, duhet të përdoren në të gjitha rastet;
- « **mjetet (toolsat) e tjera** »: konsiderohen si të dobishme për mënyrën e auditimit, ato janë zgjedhur në varësi të situatës, në bazë të gjykimit të audituesit.

**Kjo paketë nuk ka për qëllim të jetë e plotë.**

**Përdorimi i duhur i toolsave të Pack SMEs është përgjegjësia e vetme e audituesit dhe spozohet që audituesi ka njohuritë e duhura mbi Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), Standardet Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë (ISQC1) dhe Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël (kodi IESBA );**

**Nuk e përjashton atë nga kryerja e procedurave të auditimit të përshtatshme për çdo angazhim auditimi, ose të përdorë mjete të tjera për të dizajnuar këto procedura. Prandaj, nuk përfshin programe standarde auditimi.**

## Faza 1 – Pranimi i angazhimit

Përpara pranimit të një angazhimi auditimi, audituesi **vlërëson nëse mund të kryejë angazhimin**, në pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat, Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël, Standardet Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë (ISCQ1) dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA).

*Në kontekstin e Entiteteve të Vogla dhe të Mesme*, plotësimi i një pyetësoi të shkurtër lehtëson identifikimin e fushave kryesore të rrezikut që do të vinin në pikëpyetje pranimin e angazhimit:

### >> A1.1 – Checklistë për pranimin e angazhimit

Përpara pranimit të angazhimit, audituesi takohet me drejtimin e entitetit. Pas këtij takimi, ai përgatit një propozim për shërbimet e auditimit për të dokumentuar çështjet e diskutuara. Ky propozim është vecanërisht i dobishme për drejtimin për nisjen e ftesës për tender.

### >> B1.1 – Propozimi për shërbime auditimi

Pasi vendimi për pranimin është marrë dhe dokumentuar, audituesi vëzhgon një numër procedurash:

- **me audituesin e mëparshëm**, duke kërkuar detaje mbi përfundimin e angazhimit të tij dhe pengesave të hasura, nëse ka, gjatë kryerjes së angazhimit të tij:

### >> B1.2 – Letër për audituesin e mëparshëm

- **me klientin**, duke specifikuar kushtet e angazhimit (objektivi dhe qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare, përgjegjësitë e audituesit, përgjegjësitë e drejtimin, identifikimi i kuadrit të zbatueshëm të raportimit i përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare, forma dhe përmbajtja e pritur e raportit të audituesit, tarifat,...):

### >> B1.3 – Letra e angazhimit

- **me anëtarët e grupit të auditimit**, duke u kërkuar të zotohen në përputhje me politikat dhe procedurat e firmës, të cilat përfshijnë Seksionin 290 dhe Seksionin 291 të Kodit të Etikës për Profesionistët Kontabël të IESBA (kodi IESBA):

### >> B1.4 – Pranimi i pavarësisë

## Faza 2 – Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalisë materiale & Planifikimi i auditimit

Gjatë kësaj faze, audituesi siguron një kuptim të entitetit, përfshirë kontrollin e brendshëm të entitetit, për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet e anomalisë materiale në pasqyrat financiare (e përbërë nga dy komponentë: rreziku i vetvetishëm dhe rreziku i kontrollit).

Si hap i parë, audituesi kryen analizën në një nivel të përgjithshëm të pasqyrave financiare, më pas në nivelin e ciklit të auditimit për ato cikle që konsiderohen si materiale.

Më tej, në fazën e planifikimit të auditimit dhe përgjatë auditimit, audituesi konsideron mundësinë që një mashtrim mund të ekzistojë dhe rrezikun e aftësisë së entitetit për të vazhduar në vijimësi. Për këto qëllime, ai shpjegon dhe dokumenton këto konsiderata brenda entitetit në mënyrë për të krijuar planin e auditimit.

Kuptimi i kërkuar për të vlerësuar rrezikun e vetvetishëm përfshin:

- Industrinë e entitetit, mjedisi rregullator dhe faktorë të tjerë të jashtëm,
- Natyra e entitetit (operacionet, pronësia, struktura qeverisëse, llojet e investimeve, mënyrën e strukturimit të entitetit dhe si është financuar),
- Përzgjedhja e entitetit dhe aplikimi i politikave kontabël,
- Objektivat dhe strategjitë e entitetit, dhe rreziqet e biznesit që mund të rezultojnë në rreziqe të anomalisë materiale,
- Matja dhe rishikimi i performancës financiare të entitetit.

Kuptimi i kërkuar për të vlerësuar rrezikun e kontrollit mbulon **kontrollet e brendshme** të rëndësishme për auditimin.

Për cdo pohim për cdo klasë transaksioni, cdo tepriçë llogarie dhe cdo shënim shpjegues në pasqyrat financiare, nëse konsiderohet si materiale, audituesi:

- Identifikon anomalitë materiale të mundshme,
- Kërkon për kontrole të entitetit që mund të parandalojnë ose zbulojnë këto anomali, dhe rrjedhimisht të vlerësojë rrezikun e anomalive materiale.

Në kontekstin e Entiteteve të Vogla dhe të Mesme, vlerësimi për rreziqet e anomalive materiale kryhet në përputhje me madhësinë e entitetit dhe shkallës së përfshirjes së drejtimit në procesin e vendimmarrjes dhe kontrollit.

## Faza 2 – Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalisë materiale & Planifikimi i auditimit (vazhdim)

Mjetet e përshtatshme për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve për anomalitë materiale në pasqyrat financiare dhe planifikimin e auditimit në këtë hap janë si në vijim.

Një rishikim analitik paraprak i përdorur si një procedurë për të vlerësuar rreziqet i mundëson audituesit të identifikojë transaksione ose ngjarje të pazakonta, shuma ose trende që mund të shfaqin rreziqe të anomalisë materiale ose çështje që kanë efekt mbi auditimin:

### >> A2.1 – Rishikimi analitik paraprak

Për të dokumentuar vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale në një nivel të përgjithshëm të pasqyrave financiare, identifikimin e cikleve materiale dhe llogarive, vlerësimin e sjelljes dhe etikës së drejtimit, dhe inpaktin e rreziqeve të indentifikuara mbi mënyrën e auditimit, audituesi pajiset me një mjet të strukturuar të quajtur «Strategjia e përgjithshme dhe plani i auditimit ». Është një mjet shumë-vjecar për të përditësuar pranimin e angazhimit, dhe të plotësohet në lidhje me matricën e analizës së rrezikut të anomalive materiale për cikël dhe për pohim:

### >> A2.2 – Strategjia e përgjithshme dhe plani i auditimit

Për të vënë në praktikë konceptin e materialitetit në mënyrë të përshtatshme gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit, audituesi dokumenton materialitetin dhe performancën e materialitetit të adoptuar për auditimin:

### >> A2.3 – Materialiteti dhe performanca e tij

Matrica e analizës së rrezikut kryhet në hapa të njëpasnjëshme duke transferuar automatikisht rezultatet përgjatë progresit të analizës: vlerësimi i rreziqeve të vetvetishme, vlerësimi i kontrollit të brendshëm dhe testet e kontrolleve, përmbledhje e vlerësimit të rreziqeve të anomalive materiale, dizajnimi i procedurave thelbësore për t'u kryer, dhe në fund, programin e auditimit që siguron lidhjen midis anomalive materiale të identifikuara për pohim dhe procedurave të planifikuara të auditimit. Shembuj ilustrues jepen në kutitë hyrëse për çdo hap: rreziqet e vetvetishme, kontrolli brendshëm, procedurat thelbësore. Këto shembuj duhet të përshtaten dhe plotësohen në përputhje me tiparet dhe karakteristikat e angazhimit të auditimit:

### >> A2.4 – Matrica e analizës së rreziqeve

Për të menaxhuar angazhimin në mënyrë më të mirë të mundshme, dhe për të konfirmuar vlerësimin fillestar, audituesi planifikon punën e auditimit, planifikon natyrën dhe shtrirjen e burimeve të nevojshme për të kryer angazhimin dhe për të monitoruar kohën:

### >> B2.1 – Programi i auditimit

Për të ndihmuar në dokumentimin e testeve të kontrolleve, fletët e përshtatura të punës i jepen audituesit:

### >> B2.2 – Testet e kontrolleve

Në fund të fazës së identifikimit dhe vlerësimit të anomalive materiale, audituesi takohet me drejtimin e entitetit për të paraqitur analizën e rrezikut, për t'i informuar mbi pikat e forta dhe mangësitë e kontrolleve të brendshme dhe për të paraqitur rekomandimet e tij. Raporti në vijim, e destinuar për drejtimin e entitetit, e bën më të lehtë për të drejtuar mbledhjen:

### >> B2.3 – Raporti paraprak mbi rreziqet dhe kontrollet e entitetit (PowerPoint dhe Word versions)

## Faza 3 – Reagimi ndaj rrezikut & Sigurimi i evidencës së auditimit

Audituesi ushtron gjykimin profesional për të vlerësuar nëse është siguruar evidencë auditimi e mjaftueshme dhe e përshtatshme, në mënyrë për të siguruar siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare janë të lira nga anomalitë materiale.

Përgjatë rrjedhës së auditimit, ai konsideron nëse duhet të rishikojë natyrën, kohën ose shtrirjen e procedurave të planifikuara të auditimit, bazuar në evidencën e siguruar:

Në kontekstin e Entiteteve të Vogla dhe të Mesme, skedulet lidhëse sigurojnë një lidhje esenciale midis pasqyrave financiare të audituara dhe procedurave të auditimit të kryera.

### >> A3.1 – Skedulet lidhëse

Për të kryer këto procedura auditimi, audituesi pajiset me teknika auditimi të ndryshme, përfshirë:

- Konfirmimet e jashtme:

#### >> B3.1 – Kërkesat për konfirmim

#### >> B3.2.1 – Përpunimi i konfirmimeve (*kreditorët*)

#### >> B3.2.2 – Përpunimi i konfirmimeve (*debitorët*)

- Prania në inventarizimit fizik:

#### >> B3.3 – Pyetëtori mbi praninë gjatë inventarizimit fizik

Audituesi gjithashtu pajiset me fletët e punës të përshtatura për të dizajnuar dhe dokumentuar fushën e punës së auditimit dhe për të theksuar çështjet e auditimit dhe anomalitë e identifikura:

#### >> B3.4 – Fletët e punës

Së fundi, monitorimi i raporteve kryesore e lejon audituesit të sigurojë konsistencë midis trendeve dhe evidencës së siguruar përgjatë auditimit në lidhje me entitetin dhe industrinë përkatëse:

#### >> B3.5 – Raportet kryesore

## Faza 4 – Përmbledhje e angazhimit dhe raportimi i opinionit

Në bazë të evidencës së siguruar përfshirë rezultatet e testeve të kontrolleve të kryera dhe procedurave thelbësore, audituesi përgatit një përmbledhje të konkluzioneve dhe gjetjeve të auditimit me qëllim për të arritur një konkluzion mbi opinionin e tij.

Përpara lëshimit të raportit, ai verifikon që ka qënë në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat.

*Në kontekstin e Entiteteve të Vogla dhe të Mesme*, kryerja e këtij verifikimi me një pyetësor të përshtatur duhet t'i lejojë audituesit të kontrollojë pajtueshmërinë dhe të dokumentojë trajtimin e vijimësisë, ngjarjeve të mëvonshme dhe të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen.

**>> A4.1 – Pyetësi për përfundimin e auditimit (duke përfshirë vijimësinë, ngjarjet e mëvonshme dhe komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisjen)**

Audituesi takohet me klientin e auditimit në përfundim të angazhimit për të paraqitur konkluzionet e arritura. Raporti në vijim, e destinuar për drejtimin e entitetit, e bën më të lehtë për të drejtuar mbledhjen:

**>> A4.2 – Raporti i gjetjeve të auditimit (PowerPoint dhe Word)**

Përgatitja e një memorandumit përmbledhës si shtesë e raportit të gjetjeve të auditimit i lejon audituesit të vendosë jo vetëm mbi opinion që do të shprehë por edhe mbi vazhdimin e angazhimit për periudhën tjetër:

**>> A4.3 – Memorandumi përmbledhës**

Përpara përgatitjes së raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare, audituesi siguron nga klienti i tij deklaratimet me shkrim që konfirmojnë se ai beson që ka përmbushur detyrimet e tij për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe për plotësinë e informacionit të siguruar për audituesin, dhe të mbështesë evidencat e tjera të auditimit të rëndësishme për pasqyrat financiare ose pohime specifike:

**>> B4.1 – Prezantimi i drejtimit**

Pasi këto verifikime janë siguruar, audituesi vedos si të raportojë vendimin e tij dhe përgatit raportin e tij mbi pasqyrat financiare:

**>> B4.2 – Pyetësor për të përgatitur raportin e audituesit mbi pasqyrat financiar**

**>> B4.3 – Raporti i audituesit për pasqyrat financiare**



## Konsideratat praktike

### *Si të përdorni toolsat?*

Toolsat e ofruara për ju në Pack SMEs janë office tools (paketa MS Office).

Ato janë të gatshme dhe të lehta për përdorim

Kujdes: ne **tërheqim vëmendjen tuaj mbi faktin që ato nuk përfaqësojnë vetëm një dosje të plotë auditimi** dhe duhet të plotësohen me fletë pune shtesë në bazë të rrezikut të identifikuar.

Gjithashtu, ju nuk u kërkohet të përdorni të gjitha toolsat e siguruara në Pack SMEs për cdo dosje auditimi. Audituesi vlerëson nëse përdorimi i tyre është i rëndësishëm bazuar në gjykimin profesional.

Përveç kësaj, në pyetësonin e siguar, **kur përgjigjia për disa pyetje lidhet me një qelizë të hijëzuar** (me ngjyrë të kuqe në versionin elektronik), rezulton në **vlerësimin impaktit të saj mbi strategjinë e auditimit** nga audituesi.

Së fundi, Paketa SMEs është dizajnuar për të “jetuar”: si një përdorues, ju ndoshta keni vrojtime dhe komente mbi këtë paketë (përmbajtja e toolsave të siguruara, toolsa shtesë për të sugjeruar...). Prandaj, ju ftojme t'i dërgoni ato në adresën e emailit në vijim në mënyrë për të përmirësuar versionet në të ardhmen:

### *Procedurat për aktivizimet makro*

Tre toolsa nga paketa « A2.1 Rishikimi analitik paraprak », « A2.4 Matrica e analizës së rreziqeve » dhe « A3.1 Skedulet lidhëse » përfshin makrot.

Ju duhet të mundësoni makrot në kompjuterin tuaj për të operuar këto toolsa.

Procedura për të aktivizuar makrot është e integruar në dosjen e skedarit të Pack SMEs.

Në varësi të nivelit të sigurisë të vendosur në sistemin tuaj, procedura aktivizimi të tilla mund të mos jenë të nevojshme.

[xxxx@yyy.com](mailto:xxxx@yyy.com)


*Sic është përcaktuar në marrëveshjen e përdoruesit të Pack SMEs, nuk ka suport teknik të siguar nga Instituti X për office tools të ofruar. Është përgjegjësia e audituesit për të bërë rregullime për të siguar instalimin dhe operimin e duhur.*

## Pack SMEs marrëveshja e përdorimit

- Koncepti i SME e konsideruar në Pack SMEs lidhet me cdo formë të SME-ve dhe nuk është e lidhur me asnjë shumë ose kufi. Ky koncept nuk përfshin entitetet e listuara.
- Përdorimi i duhur i toolsave të Pack SMEs është përgjegjësia e vetme e audituesit dhe spozohet që audituesi ka njohuri të duhura mbi Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), Standardet Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë (ISQC1) dhe Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël (kodi IESBA );
- Nuk e lehtëson atë nga ushtrimi i gjykimit profesional dhe nuk e përjashton atë nga kryerja e procedurave të auditimit të përshtatshme me karakteristikat dhe specifikat e cdo angazhimi auditimit, duke siguruar pajtimin me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA);
- Në mënyrë për të përdorur Pack SMEs nën kushtet më të mira, audituesit rekomandohen të ndjekin seanca trainimi të përshtatura për SME-të të ofruara nga *[emri i institutit profesional në të cilin audituesi është anëtar]*;
  - Përdorimi i Pack SMEs office tools kërkon konfigurimet kompjuterike minimale në vijim:
    - Sistemi i operimit: Windows XP
    - Versioni i MS Office: 2003 (performancë optimale nga MS Office 2007);
  - Nuk ka suport teknik të siguruar nga instituti profesional për office tools të ofruara. *Është përgjegjësia e audituesit për të bërë rregullime për të siguruar instalimin dhe operimin e duhur.*
  - Tre toolsa nga paketa « A2.1 Rishikimi analitik paraprak », « A2.4 Matrica e analizës së rreziqeve » dhe « A3.1Skedulet lidhëse » kërkojnë një procedurë për të aktivizuar makrot për t'u aplikuar (shiko faqen 8).

The Audit Pack for SMEs mund të shkarkohet  
nga ëbsite i Instituti XXX

*[Instituti XXX] adresa e ëbsite*





# METODA PER AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TE ENTITETEVE TE VOGLA DHE TE MESME

SNA version - Mars 2017

